

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET


TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK

Selia: Rr. Sami Frashëri, Pall. TID
Tirana – Albania

Pasqyrat Financiare per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(me raportin e audituesit të pavaruar ne vazhdim)

Tirane, 30 Mars 2016



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Përmbajtja

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime



Raporti i Audituesit te Pavarur

Ortakut të Shoqërisë

“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK

Rr. Sami Frashëri, Pall. TID

Pranë Universitetit “Marin Barleti”

Tirana – Albania

Unë kam audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur te Shoqërisë “**TID**” sh.p.k., (Shoqëria) te cilat përfshijnë pozicionin financiar(bilancin kontabël) për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 2015 dhe pasqyrën te performances(ardhurave dhe shpenzimeve, pgjitheperfshirese), pasqyrën e ndryshimit te kapitaleve të neto dhe pasqyrën e fluksit te mjeteve monetare për këtë vit si dhe shënimet shpjeguese, të përgatitura në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit aprovuar me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhezimin e Ministrit të Financave nr 4942 datë 15.06.2006 “ Për Shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, dhe te Urdherit te Ministrit te Financave Nr.64, date 22.07.2014”Per shpalljen e Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara dhe zbatimin e detyrueshem te tyre”.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te këtyre pasqyrave financiare ne përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshëm te përshtatshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare që të mos përmbajnë anomali dhe gabime materiale, te cilat mund te kenë ndodhur për shkak te mashtrimit ose për shkak te gabimeve apo pasaktësirave, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave te duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël qe janë te përshtatshme për rrethanat

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia e imë është që, bazuar ne auditimin e kryer, te shpreh një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kam kryer ne pajtim me Standardet Ndërkombëtare te Auditimit. Këto standarde kërkojnë qe ne te respektojmë kërkesat etike dhe te planifikojmë dhe te kryejmë auditimin me qellim qe te përftojme siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për te marrë evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve ne pasqyrat financiare. Këto procedura te cilat zgjidhen ne varësi te gjykimit te audituesit, përfshijnë vlerësimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave financiare, që mund te kenë ndodhur për shkak te mashtrimit ose të

gabimeve. Për realizimin e vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të pasqyrave financiare të shoqërisë me qëllim që hartojë procedura të auditimit të përshtatshme sipas situatës, por jo me qëllimin e shprehjes së një opinioni lidhur me efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë besoj se evidenca e auditimit që kam marrë për ushtrimin 2015 është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u përdorur si bazë në dhënien e opinionit tim të audituesit.

Opinion

Sipas opinionit tim pasqyrat financiare, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale për vitin 2015, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqerte të situatës financiare të shoqërisë "**Tirana International Development**" sh.p.k., me 31 Dhjetor 2015, të rezultateve të veprimtarive të saj dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur, të përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Firma : Leze ABAZI

Eksperti Kontabël i Regjistruar



Datë : 30 Mars 2016

Adresa: Lagje Nr.4
Sarandë-Albania

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Bilanci Kontabël

AKTIVET	Shenime	Më datën 31.12.2015	
		31.12.2015	31.12.2014
AKTIVET AFATSHKURTRA			
Aktivët monetarë	4.1;4.2	112,495,051	46,751,883
Totali		112,495,051	46,751,883
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kerkesa të arktueshme	5.a)	544,768,814	744,408,165
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5.b)	128,640,757	19,244,100
Instrumenta të tjera borxhi	5.c)	21,797,871	27,628,245
Totali	6	695,207,442	791,280,510
Inventari			
Lendet e Para		95,354,038	32,598,320
Mallra		10,348,472	9,714,057
Inventari i imet		4,122,957	6,747,442
Produkte të gatshme në ndërtim		189,502,192	
Totali		299,327,659	49,059,819
Parapagime dhe shpenzimet e shtyra	7	136,698,997	115,103,982
TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA		243,729,149	1,002,196,194
AKTIVET AFATGJATA	8		
Investimet financiare afatgjata			
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	8.a)	18,412,239	7,005,000
Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata	8.b)	145,428,995	1,461,371,354
Totali		163,841,234	1,468,376,354
Aktive afatgjata materiale	9		
Ndërtesa		530,996,324	558,943,498
Makinëri e pajisje		85,695,436	91,495,275
Mjete inventari, transport, informatike		15,251,991	25,370,036
Aktive material në proces (ndërtim)		2,009,001,643	
Totali		2,640,945,394	675,808,809
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA		2,804,786,628	2,144,185,163
TOTALI I AKTIVEVE		4,048,515,777	3,146,381,357
DETYRIMET AFATSHKURTRA	10.1		
Huë dhe Parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	10.1/a)	541,579,521	309,172,040
Te pagueshme ndaj punonjësve	10.1/b)	3,582,946	3,907,428
Detyrimet tatimore	10.1/c)	7,791,991	1,745,389
Arëtime në avangë për porosi	10.1/d)	4,082,708	
Totali		557,037,166	314,824,857
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA		557,037,166	
DETYRIMET AFATGJATA	10.2		
Huë afatgjata			
Huë, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	10.2/a)	1,590,148,470	1,084,452,384
Totali		1,590,148,470	1,084,452,384
Huëmarrje të tjera afatgjata	10.2/b)	608,201,586	500,686,772
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA		2,198,350,056	1,585,139,156
TOTALI I DETYRIMEVE		2,755,387,222	1,899,964,013
KAPITALI	11		
Kapitali aksioner, themeltar		650,734,000	650,734,000
Rezervat ligjore	11	1,365,170	1,365,170
Fitimet e pashpërndara	11	594,318,174	576,952,434
Fitimet (humbja) e vitit financiar	13	46,711,212	17,365,740
TOTALI KAPITALIT		1,293,128,555	1,246,417,344

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-22



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Pasqyra e të Ardhurave

		Për periudhën që përfundon më 31.12.2015	
		31.12.2015	31.12.2014
SHITJE NETO	Shenime	1,788,000,501	389,715,552
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		17,183,251	11,351,190
Totali I te ardhurave	12.1	1,805,183,752	401,066,742
Mallrat, lendet e para dhe shërbimet	12.2	(1,474,033,695)	(216,301,348)
Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	12.3	(56,618,351)	(21,905,259)
Shpenzimet e personelit			
<i>Pagat</i>	12.4	(57,019,438)	(56,535,298)
<i>Shperblime</i>		(716,172)	(856,005)
<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqerore</i>		(9,156,767)	(8,563,739)
Shpenzime t tjera rrjedhese	12.5	(670,659)	(5,154,556)
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	12.6	(51,469,413)	(52,982,780)
Totali I shpenzimeve		(1,649,684,495)	(362,298,976)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		155,499,257	38,767,766
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet	12.7		
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare			
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	12.8	(111,963,689)	(13,350,496)
<i>Fitime (humbje) nga kursi I kembimit</i>	12.9	(15,560,997)	(155,740)
Totali I te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(96,402,692)	(13,506,236)
Fitimi (humbja) para tatimit	13	59,096,565	25,261,530
Shpenzimet e tatim fitimit	13	(12,385,353)	(7,895,790)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		46,711,212	17,365,740

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-22

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e flukseve monetare– Metoda indirekte
Për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

	Viti 2015	Viti 2014
Fluksi nga aktiviteti operativ	1,480,545,503	(282,260,880)
Fitimi neto pas tatimit	46,711,212	17,365,740
Ndryshimi i klientave	199,639,351	(287,424,010)
Furnitore –debitore	6,812,446	1,748,957
Parapagime	(13,655,195)	
Shteti tvsh	(107,213,894)	(2,212,313)
Shteti tatim fitimi	4,659,986	
Furnitoret	232,407,481	(67,071,381)
Hua te dhena afatshkurtra	5,830,374	46,738
Situacione te pushitura	1,221,336,070	52,933,558
Te tjera kerkesa (tatim fitimi)		(493,490)
Huara te dhena afatgjata	(94,895,906)	(16,802,374)
Sigurime shendetsore dhe shoqerore		
Pagat	(324,482)	(123,672)
Detyrime shteti tatim taksa, tvsh,TAP.etj	6,046,602	184,072
Hua te marra afatgjata		
Parapagime dhe pagesa pjesore	(21,595,015)	(15,729,112)
Ndyshimi i inventarit	(60,765,648)	(17,666,373)
Amortizimi	51,469,413	52,982,780
Shuma te arketuara per porosi	4,082,708	
Fluksi i parave nga aktiviteti investues	(129,267,596)	(129,267,596)
Ndryshimi i Kapitali themeltar		
Blerje dhe rivleresime AQT të tjera	(7,604,353)	(124,613,994)
Pakesim AQT nepermjet shitjes		2,346,398
Riklasifikim i aktiveve ne proces	(1,344,519,889)	
Shtese aktiveve ne proces	(664,481,754)	
Rritje e kuotave pjesmarrie	(11,407,239)	(7,000,000)
Fluksi i parave nga aktiviteti Financues	(2,028,013,235)	448,401,102
Huara te tjera	107,514,814	500,686,772
Hua bankare	505,696,086	(37,285,670)
Shperndarje dividendi		(15,000,000)
	613,210,900	
Fluksi neto i parave	65,743,168	36,872,626
	Likuiditetet	Likuiditetet
Teprica ne fillim	46,751,883	9,879,257
teprica ne fund	112,495,051	46,751,883
Diferenca	65,743,168	36,872,626

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

000/lek.

	Kapitali Themeltar	Rezerva statusore dhe ligjore	Rezerva te tjera	fitimi i pashperndare	Fitimi i periudhes	totali
Pozicioni me 31.12.2012	650,734			551,202	59,811	1,261,747
Kalimi i fitimit 2012 ne fitimit te akumuluar				59,811	(59,811)	-
Fitimi neto i vitit financiar					27,303	27,303
Pakesim fitime te pashpernadra						
Shpendarje dividendi				(45,000)		(45,000)
Pozicioni me 31.12.2013	650,734			566,013	27,303	1,244,052
Kalimi i fitimit 2013 ne fitimit te akumuluar				27,303	(-27,303)	-
Fitimi neto i vitit financiar					17,366	17,366
Pakesim fitime te pashpernadra		1,365,	(1,365,170)			
Shpendarje dividendi				(15,000)		(15,000)
Pozicioni me 31.12.2014	650,734	1,365,		576,953	17,366	1,246,418
Kalimi i fitimit 2014 ne fitimit te akumuluar				17,366	(17,366)	-
Fitimi neto i vitit financiar					46,711	46,711
Pakesim fitime te pashpernadra						
Shpendarje dividendi						
Pozicioni me 31.12.2015	650,734	1,365,		594,319	46,711	1,293,129

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-22

Pasqyrat Financiare "Tirana International Development" Shpk janë aprovuar nga Drejtimi i Degës
Më datë 03 Mars 2016

Behar Male

Administrator i vetëm

Behar Male
TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA ALBANIA

Arta Halili

Shëfë e Financës

Arta Halili

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria TID sh.p.k., në vijim e quajtur Shoqëria, është themeluar me vendimin e Gjykatës Tiranë nr.20374, në vitin 1998 në datën 3 të muajit Dhjetor, nga ortaku i vetëm, i cili ishte edhe administrator i shoqërisë, z. Behar Male. Gjatë viteve kapitali i shoqërisë ka ndryshuar dhe këto ndryshime janë formalizuar me vendimet përkatëse të gjykatës së Tiranës.

Në datën 31 Dhjetor 2015 përberja dhe zotërimi i kapitalit të shoqërisë TID sh.p.k. është 650,734,000 lekë dhe paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Vlera e kapitalit	Numri i pjeseve	% e kapitalit
BEHAR MALE	650,734,000	100	100%
Totali	650,734,000	100	100%

Ortak i vetëm dhe Administrator i shoqërisë është Behar Male.

Objekti kryesor i shoqërisë është Import-eksport, rieksporim, tranzitim, tregetim të gjitha mallrave të ndryshëm me shumice e pakice, produkte me origjin buqesore, blektorale, mallra të ndryshëm ushqimor të gatshëm e gjysem të gatshëm, materiale ndertimi të llojeve të ndryshme, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare. Marrje persiper e hartimit të projekteve të ndryshme ndertimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të anes ndertimore të tyre. Investime në fushën e turizmit, infrastrukture, konvertim të valutave, qiradhenes se zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme Veprimtari në fushën e estetikës dhe dermokozmetikës, hapja dhe mbajtja e qendrave me profil estetikën, dermo-kozmetikën, trajtimin e lëkurës dhe trupit, masazheri dhe mirembajtje trupore, fitness dhe pishina. Gjatë vitit 2014 shoqëria ka vazhduar me aktivitetin në ndertim, qiradhenie, veprimtari tregtare në fushën e shërbimeve të kujdesit ndaj shëndetit si qendra wellnes , qender sportive ,etj.

Adresa e Shoqërisë është : Rruga "Abdi Toptani " TID Tower , nr. 18.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degen e Tatimpaguesve të Medhenj me NIPT J82427007R.

Me 31 Dhjetor 2015 shoqëria ka 124 punonjës (31 Dhjetor 2014, 121 punonjës)

Sipas ligjit Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë 29.04.2004 parashikohet zbatimi në Shqipëri i dy paketave të rregullimit kontabël (a) Standardet Kombëtare të kontabilitetit si dhe (b) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregtare. Sipas këtij ligji Standardet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

- (i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (ii) Shoqëritë e Mëdha me qarkullim vjetor mbi 1.25 miliard lekë dhe mbi 100 punonjës - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standardet Kombëtare Kontabël

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 Për shpalljen e detyrueshme të tyre.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël për shifrat e vitit 2015 janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabel kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

3.1 Aktivët Afatgjatë

AAGj janë njohur në momentin kur shoqëria është bërë titullare ligjore e tyre ose ka kontrollin ekonomik mbi to, pret të marrë përfitimet në të ardhmen dhe kur mund të vlerësohen në mënyrë të bësueshme. Në njohjen fillestare aktivet vlerësohen me koston e sigurimit të tyre e cila përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve .

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Në bilanc paraqiten të vlerësuar me koston e amortizuar e cila rezulton si diferencë nga kostoja e tyre minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi i AAM të hyra gjatë vitit llogaritet në raport me kohën e hyrjes së tyre. Në rast rivlerësimi aktivet vlerësohen me koston e caktuar në raportin e ekspertit të vlerësimit. Amortizimi i AAM llogaritet në përputhje me normat e caktuara nga ligji nr. 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”. Amortizimi i ndërtesave llogaritet me metodën lienare kurse amortizimi i grupeve të tjera llogaritet me metodën e vlerës së mbetur, duke marrë përfaqësisht jetëgjatësinë e e këtyre aktiveve. Metodatat dhe normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria paraqiten si me poshte:

	Norma Amortizimit %	Metoda Llogaritjes
Ndërtesa	5%	me Vleften e mbetur
Makineri e pajisje	20	me Vleften e mbetur
Mjete Transporti	20	me Vleften e mbetur
Mobilje Orendi	20	me Vleften e mbetur
Pajisje Informatike	25	me Vleften e mbetur

3.2. Aktivet dhe detyrimet financiare

a) Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

Llogari e kërkesave të Arkëtueshme

Kërkesat e arkëtueshme ndaj klientave njihen si aktive atëherë kur Shoqëria bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për t'u arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i Shoqërisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shuma e zhvlerësimit nga borxhi i keq është diferenca midis vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të parashikuar të ardhshme të parave, të skontuar me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivit zvogëlohet duke përdorur një llogari Zhvlerësimi, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur një Llogari e Arkëtueshme nuk mund të arkëtohet, ajo nuk paraqitet në shpenzime por çregjistrohet nga Llogaria e Zhvlerësimit të borxhit të keq dhe nga Llogaria e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë ç'regjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Një aktiv financiar ç'regjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

Shoqëria paraqet në aktivet e saj të gjitha shpenzimet e parapaguara dhe të cilat pret që t'i shpërndajë në periudhat e ardhme, ose të drejtat për të ardhurat e llogaritura në avancë.

b) Detyrimet financiare

Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime tregtare të tjera dhe detyrime financiare.

Detyrime tregtare dhe të tjera paraqesin Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit)

dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

b) Detyrimet financiare - vazhdim

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së detyrimit.

3.3 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka.

Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshijnë tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Në bilanc inventarët paraqiten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme e cila është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes. Shoqëria i ka vlerësuar inventarët gjendje në fund të vitit me kosto mesatare.

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Të ardhurat nga ndërtimi njihen në masën e kryerjes së punimeve mujore

të kryera dhe situacionuara. Të ardhura nga bari dhe restoranti regjistrohen kur arkëtohen mjete monetare ose kur realizohet shitja.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Shpenzime per personelin

(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si nje shpenzim personeli ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme atehere kur eshte perdorur nga personeli perkates.

3.6 Transaksionet me monedhat e huaja

Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon shoqëria (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2015 janë:

Data /	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Monedha		
Euro	137.28	140.14
USD	125.79	115.23

3.7 Rezultati tatimor

Shoqëria llogarit vetëm tatimin aktual. Ajo nuk ka zgjedhur përdorimin e tatimit të shtyrë mbi fitimin. Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në

rezultatit kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon t'i paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e parave në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Konvertimi i gjendjes në valutë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2015 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultat. Shoqëria nuk ka ekuivalente të mjeteve monetare

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës në kontabilitet përputhet me gjendjen sipas nxjerrjes së llogarive bankare. Përbërja analitike e llogarive bankare paraqitet si vijon:

	Viti 2015	Viti 2014
	Në lekë	Në lekë
Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera		
Banka ne leke	767,296	859,803
Banka ne monedhe te huaj	47,132,079	45,258,358
Totali	47,899,375	46,118,161

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja në arkë në vitin 2015 përbëhet nga gjendjet e parave në monedhën kombëtare lek dhe në euro në fund të periudhës.

	Viti 2015	Viti 2014
	Ne leke	Në lekë
Para ne dore (arke)		
Arka ne lek	26,431,560	301,545
Arka ne euro	38,164,116	332,177
Totali	64,595,676	633,722

5. Te drejta te arketueshme

Në kete post me date 31 Dhjetor 2015, paraqiten ne bilanc kërkesat ndaj të tretëve me vleren e tyre te arketueshme. Ato përbëhen tërësisht nga të drejtat ndaj klientave, furnitore, debitore, shteti tatim taksa, instrumenta të tjera borxhi. Përbërja analitike e këtyre të drejtave paraqitet si vijon:

5.a Nga aktiviteti i shfrytëzimit

Paraqitja e llogarive të arkëtueshme jepet në tabelën vijuese:

Nr.	Kliente	Viti 2015	Viti 2014
-----	---------	-----------	-----------

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Kliente investitore privat	50,431,456	50,431,456
Institucione buxhetore	1,402,624	1,402,624
Kliente te tjere	492,934,734	692,574,085
TOTALI	544,768,814	744,408,165

5.b Te drejta te tjera te arketueshme

Paraqitja e te drejta te tjera të arkëtueshme jepet në tabelën vijuese:

Furnitore Debitore	Viti 2015	Viti 2014
Parapagime dhe pagesa pjesore	13,655,195	6,812,446
Shteti “Tatim Taksa”	114,985,562	12,431,654
Totali	128,640,757	19,244,099

Në grupin e “Shteti tatime e taksa” paraqiten elementët vijues:

Shteti tatim dhe taksa	Viti 2015	Viti 2014
Tvsh e paguar ne dogane	0	132,756
TVSH	114,985,562	7,639,912
Tatim fitimi	0	4,659,986
Totali	114,985,562	12,431,654

5.c Instrumenta te tjera borxhi

Paraqitja e Instrumentave te tjera borxhi jepet ne tabelen e meposhtme:

	Viti 2015	Viti 2014
Hua Kruja S	1,871,154	1,871,154
Banka Popullore ne sponsorizim	3,453,149	3,525,090
Hua Ardi 2M	16,473,567	32,932,900
Debitore te ndryshem	0	(10,700,899)
Totali	21,797,870	27,628,245

6. Inventaret

Gjendja e inventarëve materialeve te para analitikisht paraqiten si ne tabelen vijuese:

Emertimi	Viti 2015	Viti 2014
Materiale dhe Lende te para	95,354,038	32,598,320
Te tjera gjendje inventari	4,122,957	6,747,442
Produki i gatshem (ndertimi)	189,502,192	
Mallra	10,348,472	9,714,057
Totali	299,327,659	49,059,819

7. Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelen me poshte:

Shpenzime, kosto per tu shperndare	Viti 2015	Viti 2014
---	------------------	------------------

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Kosto për tu shpërndarë-Projekti Drini & takse ndërtimi	136,698,997	108,927,898
Pishina & SPa	0	6,176,084
Totali	136,698,997	115,103,982

Në zërin Kosto për tu shpërndarë – Projekti Drini dhe Taksa ndërtimi, përfshihen shpenzimet projekte dhe takses ndërtimi për objektin që është në process ndërtimi, në rrugën "28 Nentori".

8. Aktivet financiare afatgjata

Në këtë grup përfshihen disa nëngrupe të A.financiare afatgjata.

8.a) Investime në pjesmarrje

Paraqet një pjesmarrje në kapital në shoqëritë si me poshte :

Pjesmarrje te tjera në njësi të kontrolluara	Viti 2015 Në lekë	Viti 2014 Në lekë
Pjesmarrje në shoqëri Hydroborsh shpk	7,005,000	7,005,000
Pjesmarrje në shoqëri The Plaza Tirana sha	4,500,000	
Pjesmarrje në shoqëri Konsorciumi për zhvillim	6,907,239	
Totali	18,412,239	7,005,000

8.b) Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata	Viti 2015 Në lekë	Viti 2014 Në lekë
Llog/kerkesa te ark. Afatgjata, (Situacione)	0	1,413,637,182
Llog/ Kërkesa te arkëtueshme afatgjata(Hua)	145,428,995	50,533,092
Totali 1	145,428,995	1,464,170,274

Përbërja e zërit Kërkesa të arkëtueshme afatgjata (Hua) paraqitet si vijon:

Kërkesa (Hua) të arkëtueshme afatgjata	Viti 2015	Viti 2014
Kredi të dhena të tregjeve	145,428,995	50,533,092
Totali	50,533,092	33,730,718

9. Aktivet Afatgjata

Gjatë vitit 2015 shtesat e AAM janë paraqitur me koston e tyre.

Në vijim paraqitet një pasqyrë në lidhje me lëvizjet e Aktiveve Afatgjata dhe Amortizimit të tyre gjatë vitit 2015:

Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Afatgjata				
Emertimi i Aktivit	Gj. me 01.01.2015	Riklasifik,	Shtesat	Daljet
			gjate vitit	gjate vitit
Shpenzimet e nisjes				Gj. me 31.12.2015
Ndertesat	766,823,808			

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

			766,823,808
Instalime, makineri e pajisje	183,233,834	5,832,634	183,233,834
Mjete transporti	12,375,664		12,375,664
Produkte ne proces	1,344,519,889	664,481,754	2,009,001,643
Pajisje zyre e informatike	37,023,453	1,771,719	37,023,453
Totali	999,456,759	1,344,519,889	672,086,107
			3,016,062,755

Pasqyra e Ndryshimit te Amortizimit te Aktiveve Afatgjata Materiale

Emertimi i Aktivit	Gj. me 01.01.2015	Riklasifimi	Amortizimi	Pakesime nga	Gj. me 31.12.2015
			Vjetor	dalje AQT	
Ndertesa	207,880,310		27,947,174		23,5827,484
Instalime, makineri e pajisje	91,738,559		18,230,930		109,969,489
Mjete transporti	5,956,716		1,283,791		7,240,507
Pajisje zyre e informatike	18,072,365		4,007,517		22,079,882
Totali	323,647,950		51,469,412		375,117,362

Teprica me Vleften e mbetur te Aktiveve Afatgjata Materiale

Emertimi i Aktivit	Gj. me 01.01.2015	Shtesat	Daljet	Gj. me 31.12.2015
		gjate vitit	gjate vitit	
Shpenzimet e nisjes				
Ndertesa	558,943,498		27,947,174	530,996,324
Instalime, makineri e pajisje	91,495,275	5,832,634	18,230,930	79,096,979
Mjete transporti	6,418,948		1,283,791	5,135,157
Produkte ne proces	1,344,519,889	664,481,754		2,009,001,643
Pajisje zyre e informatike	18,951,088	1,771,719	4,007,517	16,715,290
		1,344,519,889		
Totali	675,808,809	672,086,107	51,469,412	2,640,945,393

Shtesat e aktiveve në vitin 2015 per ndertesen ne masen prej 1,344,519,889 lek ka ardhur nga pakesimi i aktiveve afatgjata, (situacione) pjese e koston se objekti Drini , e cila ka kaluar ne AAM ne proces. Shtesat e tjera kanë ardhur nga blerjet, te cilat janë njohur me koston e blerjes, ndërsa pakesimet kane ardhur nga amortizimi i plote i disa pajisjeve te inventarit, si dhe amortizimet vjetore.

10. Detyrimet

Detyrimet perbehen nga detyrimet afatshkurtera dhe ato afatgjata. Sipas kontabilitetit te klasifikuara ne kete kriter ato paraqiten:

10.1 Detyrimet afatshkurtera

Paraqitja e tyre ne bilancin kontabel jepet si ne tabelen qe vijon:

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" "SHPK"
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Detyrime afatshkurtera	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Furnitorë për blerje e shërbime	541,579,521	309,172,040
Personeli	3,582,946	3,907,429
Detyrime tatimore	7,791,991	1,745,389
Arketime ne avance per porosi	4,082,708	
Totali	557,037,166	314,824,857

10.1/a) Detyrimet ndaj Furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve jane paraqitur ne bilanc per shumat qe do te paguhen pas dates 31.12.2015. Një paraqitje analitike e tyre jepet ne tabelen më poshte:

Furnitore	Viti 2015 Në Lekë
Furnitorë në Euro	692,148
Furnitorë në Lekë	540,887,373
Totali	541,579,521

10.1/b) Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqet detyrimin e shoqerise ndaj punonjesve per pagen e muajin dhjetor e cila eshte paguar ne muajin janar 2015.

10.1/c Detyrimet Tatimore

Detyrimet ndaj shtetit per tatime e taksa paraqiten ne seksionin e detyrimeve afatshkurtëra ne Pasqyrat financiare. Perbërja analitike e këtyre detyrimeve ndaj shtetit paraqitet si vijon:

Shteti tatime e taksa	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Tatim mbi te ardhurat personale	0	504,574
Sigurimet shoqerore	1,577,712	1,240,815
Tatim fitimi	2,147,593	
Taksa dogane	3,384,719	
Tatim ne burim	207,000	
Tatim pasurije	474,967	
Totali	7,791,991	1,745,389

Sigurime shoqerore e te ngjashme paraqesin shumen e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe TAP te llogaritura mbi pagat e punonjesve per muajin dhjetor. Keto detyrime jane paguar ne muajin janar 2016.

Takse dogane paraqet detyrimin per taksa dogane te cilat jane paguar ne janar 2016. Tatim ne burim paraqet detyrimin e tatimit ne burim te muajin dhjetor i cili eshte paguar ne janar 2016. Tatim pasurije paraqet detyrimin e taksave te pasurise te paguara ne Bashki ne muajin janar 2016.

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

10.2 Detyrimet afatgjata

Përbërja e detyrimeve afatgjata paraqitet si vijon:

Huate afatgjata	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate	1,590,148,470	1,084,452,384
Huamarrje te tjera afatgjata	608,201,586	500,686,772
Totali	2,198,350,056	1,585,139,156

10.2/a) Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate

Përbëhen nga huat bankare afatgjata. Një paraqitje e tyre jepet në tableën vijuese:

Huat bankare afatgjata	Viti 2015 Ne leke	Viti 2014 Ne leke
FIB	188,164,106	210,210,000
Tirana bank	82,368,000	81,749,548
Banka Popullore	44,108,694	71,693,443
Alfa Bank	698,133,981	326,364,572
BKT	302,813,689	394,434,821
Raifescien bank	274,560,000	
Totali	1,590,148,470	1,121,738,054

10.2/b) Huamarrje te tjera afatgjata

Ne kete ze perfshihet detyrimi qe shoqeria TID i ka Agna Investitor ne masen prej 608,201,586 lek.

11 Kapitale te veta

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta per vitin 2015 jepet në pasqyrën vijuese:

Kapitali Aksionar qe i perket aksionereve te shoqerise					
Me date 31.12.2014					
	Kapitali Themeltar	Rezerva statusore dhe ligjore	Rezerva te tjera	fitimi i pashperndare	Fitimi i periudhes
Pozicioni me 31.12.2012	650,734			551,202	59,811
Kalimi i fitimit 2012 ne fitimit te akumuluar				59,811	(59,811)
Fitimi neto i vitit financiar					27,303
Pakesim fitime te pashpernadra					
Shpendarje dividendi				(45,000)	
Pozicioni me 31.12.2013	650,734			566,013	27,303
Kalimi i fitimit 2013 ne fitimit te akumuluar				27,303	(-27,303)
Fitimi neto i vitit financiar					17,366
Pakesim fitime te pashpernadra		1,365,		(1,365,)	
Shpendarje dividendi				(15,000)	

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pozicioni me 31.12.2014	650,734	1,365,	576,953	17,366	1,246,418
Kalimi i fitimit 2013 ne fitimit te akumuluar			17,366	(17,366)	-
Fitimi neto i vitit financiar				46,711	46,711
Pakesim fitime te pashpernadra					
Shpendarje dividendi					
Pozicioni me 31.12.2014	650,734	1,365	594,317	46,711	1,293,129

Kapitalet e veta te shoqerise leke dhe jane shtuar nga fitimi i vitit ne masen prej 46,711 mije lek.

12. Të ardhurat dhe shpenzimet

Për periudhën kontabël që mbyllet më 31 dhjetor 2015 shoqëria "TID" shpk ka kryer shpenzime dhe ka realizuar të ardhura të cilat janë paraqitur përkatësisht në klasat 6 dhe 7.

12.1 Shitjet neto

Gjatë vitit 2015 shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitjet e situacioneve, sherbimeve, qirave, shitja sherbime qendra Nobis, etj Përbërja e shitjeve neto paraqitet si në tabelën vijuese:

Të ardhurat neto	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Nga kryerja e sherbimeve, Situacionet	1,549,101,424	174,567,002
Nga shitja e produkteve te prodhimit vet	116,171,106	119,422,408
Te tjera	9,620,336	11,351,190
Nga qirate	113,107,635	95,726,142
Totali	1,788,000,501	401,066,742

Në grupin e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve jane paraqitur situacionet e punimeve te kryera per vitin 2015.

Ne te ardhurat nga shitja e produkteve te prodhimit te vet praqiten si me poshte:

Te ardhura nga shitja e produkteve te veta	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Te ardhura nge qendra Nobis	116,171,106	117,679,021
Te ardhura te tjera nga shitja e mallrave	9,620,336	1,743,387
Totali	125,791,442	119,422,408

Te tjera Shitje e Sherbime

Te ardhura nga " Te tjera shitje e sherbime" ne menyre analitike pasqyrohet si me poshte:

Te ardhura nga te tjera shitje e sherbime	Viti 2015 NëLekë	Viti 2014 Në Lekë
Te ardhurat nga shperndarje e faturave Telefonit	98,743	0

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Te ardhurat nga shperndarja e faturave të Energjië, ujit dhe karburantit	2,038,697	1,881,625
Te ardhura nga shitja e AAM		5,181,110
Te ardhurat nga autofaturat	15,045,811	4,288,455
Totali	17,183,251	11,351,190

Te ardhurat nga autofaturat perfaqesojne autofaturimin e sherbimeve te kryera nga persona qe nuk jane rezidente ne Shqiperi, projekte, sherbime manaxhimi,etj.

Ne te ardhurat nga qirate, jane perfshire te ardhurat e realizuara nga dhenia me qira e ambienteve ne Qendren e Biznesit "Twin Tower" ne bulevardin "Deshmoret e Kombit", dhe te ambienteve te tjera. Per keto te ardhura shoqeria ka prere fatura tatimore shitje pa perfshire TVSH pasi qirate jane me afat mbi 2 muaj.

12.2 Mallrat, Lendet e para dhe sherbimet

Në këtë post janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para, mallrave dhe materialeve ndihmëse për aktivitetin e ndertimit dhe te tregetise dhe sherbimet ne funksion te aktivitetit kryesor te shoqerise si shpenzime per punimet nga nenkontraktoret, shpenzime per energji elektrike, transport, etj. Analitikisht përbërja e këtij zëri të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet si vijon:

Mallrat, Lendet e para dhe sherbimet	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Lendet e Para	512,126,377	31,918,643
Mallra	17,428,399	16,071,019
Trajtime te pergjithshme,	885,538,234	130,971,710
Shpenz. Energji + uje	35,838,227	24,374,560
Qira + mirembajtje dhe riparime	13,240,395	9,740,943
Transport materialesh	9,862,062	3,224,473
Totali	1,474,033,695	216,301,348

Ne zerin trajtime te pergjithshme perfshihen sherbimet nga te trete per procesin e ndertimit,etj.

Ne zerin Qera dhe mirembajtje perfshihen shpenzime qira ne qendren nobis si dhe kuota e administrimit.

12.3 Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Primet e sigurimit	812,177	600,152
Te ndryshme,noterizime +anceleri,	6,799,893	1,793,043
Pagesa te ndermjetme dhe honorare, anetaresim	14,299,364	1,920,689
Reklama, publicitet	3,847,282	4,160,740
Shpenzime telefoni . vodafon dhe tel. Fiks	2,591,986,	2,961,085

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Tatime , taksa bashkie e automjete.taks. m2	9,176,595	4,090,233
Shpenzime udhetimi dhe dieta	103,408	251,238
Kerkime dhe studime		
Shpenzime per sherbime bankare	3,942,837	1,597,789
Shpenzime per autofatura	15,045,811	4,530,290
Totali	56,618,351	21,905,259

12.4 Shpenzime personeli

Gjate vitit shoqeria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punojnësit. Fondi i pagave sipas kontabilitetit eshte 57,019,438 lek , ndersa totali i pagave mbi te cilen llogariten kontributet eshte 54,530,233. Diferenca prej 2,489,207 lek pasqyron diferencen e pagave mbi nivelin e pages maksimale mbi te cilen llogariten sigurimet shoqerore . Ne zerin shperblime perfshihen shperblime ne natyre ne masen prej 716,172 lek

12.5 Shpenzime të tjera rrjedhese

Ne postin "Shpenzime te tjera rrjedhese " jane perfshire shpenzimet qe pasqyrohen si ne tabelen e meposhtme:

Shpenzime të tjera rrjedhese	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Shpenzime per pritje e perfaqesime	0	100,000
Sponsorizime e subvencione	568,500	1,620,000
Gjoba dhe penalitete	102,159	1,078,435
Vlera kontabel e AAM te shitura	0	2,356,121
Total	670,659	5,154,556

Ne zerin shpenzime per sponsorizime perfshihen sponsorizime te ndryshme te cilat jana pa fatura dhe jane shpenzime te panjohuar fiskalisht.

12.6 Zhvleresime dhe amortizime

Ne menyre analitike ky ze zberthehet:

SHpenzime amortizimi dhe zhvlerësime	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Shpenzime amortizimi	51,469,413	52,982,780
Total	51,469,413	52,982,780

Ne zerin e amortizimeve perfshihen shpenzimet e amortizimit te ndertesave, makineri e pajisje, mjete transporti dhe inventar. Per efekt te llogaritjes se tatim fitimit fiskal eshte bere zbritja e shpenzimeve te amortizimit per pjesen e rivleresuar te nderteses ne masen prej 17,806 mije lek. Ndersa shpenzimet per amortizimin e aktiveve te tjera afatgjata jane llogaritur me normat e amortizimit ne mbeshtetje te ligjit 8438 date 28.12.1998 per "Tatimin mbi te ardhurat" mbi vleren e mbetur.

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.8 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	Viti 2015 Në Lekë	Viti 2014 Në Lekë
Shpenzimet nga interesi	(111,963,689)	(13,350,495)
Fitim ose humbje nga kursi i kembimit	15,560,997	(155,740)
Total	(96,402,692)	(13,506,235)

Shpenzime per interesa paraqesin shumën e interesave të paguara për huatë e marra nga bankat e ndryshme. Ato janë llogaritur në bazë të pagesave të kryera sipas schedulit të huase.

Fitimi nga interesat per 4,322 paraqet interesat bankare të llogaritura nga bankat për gjendjen e mjeteve monetare pranë tyre. Ne kete ze praqitet shuma neto e shpenzimeve te interesave me te ardhurat nga interesat

Humbjet nga kursi i kembimit paraqesin humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve, debitore e kreditore ne monedhë të huaj dhe huave bankare.

13. Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël 59,096,565 leke. Per llogaritjen e rezultatit tatimor te vitit 2015 shoqeria ka bere rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si te panjohura per qellime fiskale nje sere shpenzimesh.

Shoqeria ka zbatuar kerkesat e ligjit "Per tatimin mbi te ardhurat" për njohje dhe mosnjohjen e shpenzimeve për efektet të llogaritjes të fitimit të tatueshëm.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe te ardhura te patatueshme te rezultatit fiskal për vitin 2015 paraqiten si në tabelën vijuese:

13. Tatimi aktual mbi fitimin

	2015	2014
Fitimi kontabel i vitit raportues	59,096,565	25,261,530
Te ardhura te pa tatueshme fiskalisht	0	0
Shpenzime te pazbritshme	(23,472,458)	(27,377,068)
Vlera e aktiveve te nxjerra jashte perdorimit	0	(431,551)
Shpenzime amortizimi mbi kufirin ligjor	(17,806,581)	(19,035,480)
Shpenzime me fatura jo te rregullta tatimore	(1,261,023)	
Gjoha dhe kamat vonesa	(102,159)	(1,078,435)
Subvencione	(568,500)	
Shperblimi i punonjesve ne natyre	(716,172)	(856,005)
Interesa per hua te dhena te treteve	(3,018,023)	(5,975,597)
Fitimi tatimor per vitin raportues	82,569,023	52,638,598

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

<i>Tatim fitimi i vitit 2015 15%</i>	12,385,353	7,895,790
Fitimi neto kontabel	46,711,212	17,365,740

14. Transaksionet me palët e lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj. Gjat' vitit 2015 shoqëria nuk ka kryer transaksione me palët e lidhura .

15. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA ALBANIA